

EMRI I QYTETIT NGA E KA ORIGJINËN MITI I ADAMIT

Fatbardha **DEMI**

Studiuese, Akademia "Rrënjët Tona"

Gjeja më e rëndësishme e shkencës është se nuk ka rëndësi se me sa shkencëtarë nuk ke mendim të njëjtë. Në fundtëfundit fiton idea e drejtë. Shkenca nuk është demokratike, nuk ka të bëjë me mendimin e përbashkët dhe as me popullaritetin. Galileu kishte të drejtë edhe pse idetë e tij nuk ishin popullore në kohën e tij.

PËRMBLEDHJE

Origjina parahistorike e emrit Epidam dhe lidhja e tij me mitin e Adamit, Dialekti tosk kyçi i zbulimit gjuhësor të emrit të lashtë të Durrësit. Emri Epidam dëshmi e simbolit të Zotit dhe të popullsisë autoktone të Gadishullit pellazgjik dhe rolit qytetruës i këtyre fiseve në Euro-Afro- Azi. Emri i Adamit bashkon tre fetë kryesore të Euroazisë, të shprehura në Bibël (Zanafilla 1-5) dhe në Kuran (Kur'an), në mitin e krijimit të Njeriut të parë në Tokë, paraardhësit të racës njerëzore. Gjuhëtarët seriozë kanë pohuar se origjina e emrit të tij është e paqartë. Fakti që gjuha shqipe, edhe sot e kësaj dite, shpjegon emrin biblik, dëshmon se ky mit është krijuar nga shqipfolësit: Adami, ku A (marrë si simbol i njërit ose në kuptimin e "të parës") + digë. (i ndarë) = (i pari) i ndarë / i krijuar nga Zoti.

Fjalë kyçe: origjina, mit, dialekt, bibla, kuran, zot

ABSTRACT

The prehistoric origin of the name Epidam and its connection with the myth of Adam, the Tosk dialect key to the linguistic discovery of the ancient name of Durrës. The name Epidam evidences the symbol of God and the indigenous population of the Pelasgian Peninsula and the civilizing role of these tribes in Euro-Afro-Asia. Adam's name unites the three major religions of Eurasia, expressed in the Bible (Genesis 1-5) and in the Qur'an (Qur'an), in the myth of the creation of the first Man on Earth, the ancestor of the human race. . Serious linguists have claimed that the origin of his name is unclear. The fact that the Albanian language, even today, explains the biblical name, proves that this myth was created by Albanian speakers: Adam, where A (taken as a symbol of one or in the sense of "the first") + dam. (divided) = (first) divided / created by God.

Key words: origin, myth, dialect, bible, quran, god.

HYRJE

Emri i Adamit i bashkon tre besimet kryesore të Euro-Azisë, i shprehur në Bibël (*Bible, Genesi 1-5*) dhe Kuran (*Qur'an*), në mitin e krijimit të Njeriut të parë në Tokë, paraardhës i racës njerëzore. Gjuhëtarët seriozë kanë pohuar se origjina e emrit të tij është e paqartë. (1) Fakti që gjuha shqipe, edhe në ditët e sotme e shpjegon emrin biblik, dëshmon se ky mit është krijuar nga shqip-folësit: Adam, ku A (merret si simbol i njëshit ose në kuptimin «i pari»)+dam (i ndarë)= (i pari) i ndarë/ i krijuar nga Zoti. Bibla kristiane përfshihet një pjesë të Testamentit të Vjetër, ku janë mbledhur fillimisht, shkrimet e shenjta të Hebregëve (Judejve). Në Fjalorin «Britannica», shkruhet se, duke u njohur me qytetërimin e madh të Babilonisë së lashtë dhe të Egjiptit, fisi i Judejve huazoi elemente të traditës e rrjedhimisht edhe të miteve të tyre, duke i përfshirë në kulturën dhe sistemin besimtar të tij.(3) Sipas këtyre të dhënave, emri i këtij qyteti (në rast se ka ekzistuar) duhet kërkuar në Babiloni ose në Egjiptin faraonik.

Gjatë studimit mbi origjinën e emrit Dardania (e përfaqësuar sot nga Kosova dhe trevat që ndodhen në shtetet kufitare), u ndeshëm me emrin e qytetit të lashtë Damast, i cili gjithashtu e shpreh mitin biblik: Dam(i ndam)+ast (është)=i ndarë është. Sipas Pr.Petro Zhejit, Da (ku A është e gjatë dhe në formë arkaike ka qënë AA) shpreh sakrificën (ndarjen) e Zotit me të cilën ai krijoi Botën materiale dhe njëriun e parë.¹

Fig. – 1 Krijimi i Adamit, pikturë e Mikelanxhelos (TheSistine Chapel Ceiling, 1512)



Pra nga ana gjuhësore Damast=Adam, por në kuptimin besimtar, nënkupton: qytet hyjnor apo krijim/ vepër e Zotit. Të njëjtin trajtim, gjuhësor e ka emri parahistorik i Durrësit- *EPIDAM* (lat. *Epidamnus* gr.*Epídamnōs*) i cili përbëhet prej dy fjalëve shqipe: Epi/Ipe (në dialektin çam)+dam, ku e para është emërtim i shqiponjës dhe e dyta, folja e lashtë «da» (u nda). Historiani arbëresh Nikoll Ketta (1747-1803) vëren se: «**nuk zotëron asnjë shtet tjetër i botës aq shumë monumente të lashta lidhur me emrat, sa Kombi ynë** (duke vënë në dukje se) të shkruara në gjuhën greke apo maqedonase, dhe më vonë, duke u shkruar në latinisht nga romakët në kohën e Perandorisë, (emërtimet) pësuan ndryshim. Kështu ka ndodhur me emrin **Epīdam** (në origjinë-**Ipedam**), sepse edhe në shekullin e 20-të, në folklorin çam, shqiponja dhe emri Epir emërtoheshin: Ipe dhe Iperi. Duhet theksuar, na kujton studiuesi Dhimitër Pilika se, në rrethanat e lashtësisë, teksa shkrimi njihej tepër pak, shenjat simbolike përbënin mjetin më të shpejtë për të kumtuar me shtresat e gjera. Në këtë drejtim, Shqiponja ishte simboli më i rëndësishëm, besimtar dhe administrativ i mbretërve arbër të Lashtësisë. Sipas mitit të pasqyruar nga Apiani (Illyrike, lib.4), shkruhet se Epidamni, mbreti i barbarëve (ilirëve) të këtij vendi, ndërtoi pranë detit një qytet dhe e quajti me emrin e tij Epidamn. I biri, i vajzës së Epidamnit, Dyrrahu, ndërtoi pranë qytetit një liman dhe e quajti Dyrrah. Barleti, duke përmendur betejën e famshme të Gaio Giulio Cesare me Gneo Pompeo Magno zhvilluar në Epidam (Dyrrachium, v.48 p.e.r.), shkruan se: *lashtësia nuk nxjerr në dritë ndonjë themelues të sigurt të saj.*

¹ Gen 1:26



Fig. – 2 Monedha e porositur nga Pirro Burri me rastin e fitores në luftë, me simbolin e përfaqësueses së Zotit - Shqiponjën dhe Hermesin pellazg (perëndin hënore Thot të Egjiptit të lashtë). Në anën tjetër, kupa e shenjtë mbi trekëndëshinkultik, simbol i besimit hënor dodonas.

Pavarësisht tregimit mitik, rëndësia e këtyre dy emrave të qytetit-port, Ipedam dhe Dyrrah, që janë format e sakta në gjuhën e themeluesve të tij shqipfolës, krahasuar me ato latine (*Epidamnus*, *Dyrrachium*) dhe të greqishtes priftërore (*Epídamos*, *Durrhákion*), qëndron tek fakti se, studiuesit shqipetar janë të një mendimi, se *ka qenë banuar pandërprë, që nga kohët parahistorike deri në ditët e sotme*. «Gjatë punimeve për thellimin e portit të ri - pohon Dr.Mojkom Zeqo (*Dy emrat e një qyteti të lashtë*, 2019) draga nxorri një çekan tipi-guri e copëra qeramike parahistorike. Kjo dëshmi jashtëzakonisht e rëndësishme, flet për vazhdimësi jete në këto brigje shumë më përpara se të konceptohej e të ngrihej qyteti antik, të cilin e kanë përmendur me emrin Epidamn shumë prej historianëve të parë, si Straboni, Tukididi, Polibi, Diodori i Siqilisë, Tit Livi. (9) Bazuar në materialin e mbledhur nga gërmimet, duke përfshirë edhe trevat e fshatrave përreth qytetit, si zona e Shijakut (brigjet e lumit Erzen, Hamallaj, Manzë, Kulle) dhe fshatrat e Kavajës (Hajdaraj, Momël, Ballaj, Tilaj, Mlik, Domen, Armath), arkeologët Hava dhe Sali Hidri (*Historia e Durrësit*) pohojnë se,«Gjetjet arkeologjike në Durrës, dëshmojnë se e gjithë kjo zonë (Gjiri i Durrësit dhe hora e tij pa kufij), *ka qenë e banuar nga popullsia autoktone pellazgo-ilire me kulturë material të njejtë, nga periudha Neoliti të vonë deri në fillim të periudhës së Hekurit (3000-1200 p. e.r.)*. Këto dëshmi tregojnë se qyteti Epidamn (Ipedam) paraqet zhvillimin historik të jetesës mijëvjeçare të banorëve të kësaj treve, sipas objekteve arkeologjike, të cilët në shekujt VII–VI p.e.r. e kishin akropolin mbi kodër, si qëndër kultike me tempuj kushtuar perëndive dhe me varre të lashta të elitës së tyre».(10)

EPIDAM, emri që lidhet me ZOTIN

Sipas Fjalorit Perseus, disa studiues pohojnë se, duke u nisur nga kuptimi negativ i fjalës epidamnus, si një ogur fatkeq, për ta ndryshuar, shkruesit latin e emërtuan qytetin Dyrrachium. Sot pranohet mendimi se emri Epidam «nga ana gjuhësore është i panjohur». Studiuesi arbëresh Xhuzepe Katapano (*Thoti fliste shqip*,2007), sqaron: emri në parim ishte një formulë strukturore, pasi shprehte, jo vetëm natyrën e brendëshme, por dhe rolin e objektit të cilit i ngjitej. Fjala emëroj: fjalë për fjalë do të thotë, prej ëmës (nënës) rroj, ekzistoj, duke saktësuar prejardhjen e qenjes në varësi dhe të disa kushteve për të ekzistuar. Gjurmët e këtij kriteri tepër të lashtë, të vendosjes së emrit, i rigjejmë më vonë në

mbiemrin i cili për të dalluar më mirë personin i shtohet këtij duke marrë shkas nga tiparet fizike apo morale. Vendi kryesues që ka zenë shqiptonja në parahistori, kanë qenë fillimisht veçoritë e saj fizike, për të cilat në popull njihet si mbretëreshë e shpendëve. Me krijimin e miteve dhe teologjisë Pellazge, që u bë burimi kryesor për besimet e mëvonshme, shqiptonja përfaqësoi Krijuesin me dy emërtime të dialektit tosk: *IPE* dhe *AIN*, që dokumentohen në folklorin e popullit tonë, shkrimet e historianëve dhe alfabetet e popujve të lashtë, si dhe emërvendet e shumta të Euro-Azisë. Faktori vendimtar në hyjnizimin e saj ka qenë besimi hënor (sellenizmi/hellenizmi) sipas të cilit **Shqiptonja përfaqëson KRIJUESIN**. Ky fakt, që lidhet me emrin besimtar të qytetit – Epidam (**I**pedam), vërtetohet me fjalën e lashtë-**APEIRON**. Ky emërtim është zbuluar fillimisht në shkrimet e pellazgut Anaksimandër (610–546 p.e.r.), i njohur si shkencëtar që u përpoq të shpjegonte dukuri të ndryshme të universit, duke këmbëngulur se natyra drejtohej sipas ligjeve sikurse edhe njerëzimi.




Fig. – 3 Portreti i Anaksimandrit, muzeu Nacional i Romës

Ai zbuloi ligjin e «vazhdimësisë pa limit» të natyrës duke e emërtuar «apeiron», i njohur sot me emrin «infinite». Sipas tij, ka patur një fillesë nga e cila e kanë origjinën të gjitha gjërat dhe drejt së cilës do të kthehen perseri, si një cikël natyror pa kufij kohorë. Sipas shkencës teosofike, që ruan shumë fakte të arkivit mitik dhe filozofik të Atlantido–Pellazgëve dhe të figurave të shquara të Lashtësisë, Infinite apo pafundësia (apeiron), nuk ka limit, përmasë apo fund. **Apeiron**, sipas filozofëve epikurian Demokritit, Neoplatonikeve dhe studiuesve të mëvonshëm, përcaktohej si hapësirë boshe, si pamje zanafillore e universit dhe si aktiviteti krijues i Zotit.




Fig. – 4 Simboli i infinitit (apeiron-it)

Në Fjalorin Wikipedia, sipas traditës në rrethet studimore, origjina e fjalës kërkohet tek «greqishtja e lashtë» (ἄπειρον, *ápeiron*) dhe zbërthehet: a /nuk+peirar,(prej formës jonike, *peras*) dhe në kuptimin letrar tregon diçka pa limit që nuk ka fund. Në filozofinë e Anaksimandrit kjo fjalë

shpreh ligjin e formimit të Universit.

Fig. – 5 Harta e Akarnanias

Filozofët e mëvonshëm nuk e njihnin gjuhën e përdorur prej studiuesit pellazg dhe e trajtuan emrin e ligjit, si shprehje e dy të kundertave: e fundit dhe pafundësisë(infinite). Anaksimandri, sipas tyre, ndoqi një hipotezë besimtare mbi ligjet e Universit, duke përdorur një



gjuhë mitike të lashtë për të treguar, se ligjet e natyrës e kishin origjinën nga ligjet hyjnore. Ky përfundim për emërtimin, është një fakt i vërtetë historik. Po cila ka qenë kjo gjuhë mitike e stërlashtë?

Vendlindja e Anaksimandrit, qyteti i Milet-it, ishte vendbanim i fiseve kariase, që njihen si pellazgë. Emërtimi *Apeiron* përmban një fjalë të gjuhës shqipe: A/1(e vetmia)+pei/ipe (shqiponja, ku «i» e fillimit është çvendosur në fund)+(ai)ron (nuk ka vdekje). E thënë në formën e sotme: *Eshtë Shqiponja* është Zoti ai që rron (perjetësisht), që në kristianizëm e gjejmë në formën YHWH (ku y/j, h/e, w/v, h/e): Je vet, (Unë jam). Dihet se në lashtësi, por edhe në ditët e sotme, emri i Krijuesit mbahet i fshehtë dhe në besimin e atlantido-pellazgëve ai përfaqësohej me emrin e Shqiponjës apo shumë emërtime të tjera. Në formën e mësipërme e gjejmë tek Homeri kur përshkruan qytetin e një ishulli në veri të Peloponezit Aktën Epeiroio, ku pjesa e parë është emri i qytetit. *Epeiroio*: Ipe/ Zoti +ro(n).

Sipas Strabonit, tregon ishujt që ndodheshin përball tokës kominentale të emërtuar *Epir(os)*. Në kohën e Homerit nuk njihet akoma emri Akarnani i kësaj krahine, pohon gjeografi, *dhe është e qartë se emri Epir tregon gadishullin përball ishujve*. Studiuesit e shekujve në vijim, fjalët e Homerit për emrin Epir dhe të Strabonit (tokë përball ishujve apo tokë e palëvizshme), i trajtuan me kuptimin e lartësisë *sipër* apo *mbi*, siç e dëshmon Fjalori plotësues i Akademisë Franceze (vol.1 i vitit 1842), për fjalët që fillojnë me rrenjën *EPI*. Fatkeqësisht edhe shkenca Albanologjike, nga ana gjuhësore vijon ta shpjegojë gabim, pavarësisht se në dialektin çam, shpendi hyjnor dhe hapësira e pjesës jugore të Albanisë së mesjetës, emërtohej me emrin *Ipe* dhe *Iperi* (Epir), i gjendur sot tek emri i shtetit *Shqipëri*, tek gjuha shqipe dhe emërtimi Kombi shqiptar. Në studimin (*Dy emrat e një qyteti të lashtë*) të arkeologut Mojkom Zeqo, shkruhet: Emri Epidamn, sipas dijetarit I.Rossut, pjesa e përparme epi që ka karakter indoeuropian, do të thotë mbi, kurse damn vjen nga një rrënjë e vjetër dama, me ndërtue dhe e ka emri i qytetit tjetër ilir, Damastion, *pra Epidamn do të thotë «ndërtim i sipërm*. Sipas fizikantit të shquar Carlo Rovelli, Anaksimandri i cili mbahet si nismëtar i mendimit shkencor, ndiqte parimin: *Të ndërtosh mbi njohurit e përftuara* (nga autorët e mëparshëm-shën im), **por duke e vënë çdo të vërtetë në dyshim**" që është rruga e vetme shkencore. Duke ju përmbajtur këtij parimi themelor të punës studimore, me ndihmën e njohurive mbi besimin hënor pellazg dhe të dialekteve të gjuhës shqipe, zbulohet origjina e vërtetë e emrit parahistorik *Epidam (Ipedam)-vepër e Zotit* (shqiponja=Zoti), siç u trajtua më lart, e për rrjedhojë gëzonte mbrojtjen hyjnore». Le të kujtojmë legendën e Luftës së Trojës, (që i përket një periudhe historike të më vonëshme, se sa ajo e qytetit arbëror, gjykuar nga emri Epidam) ku Heleni, bir i Priamit u thotë akejve se sa të ndodhej statuja e perëndeshës Athina, Troja nuk do të pushtohej dot.(20)

Në muzeun arkeologjik të Durrësit ndodhet, si objekt kulti, një statujë madhështore e Shqiponjës (e dëmtuar), dëshmi e besimit hënor monoteist Pallazg. Shumë qytete bregdetare të Lashtësisë e gëzonin këtë privilegj nga Zoti. Në Fjalorin plotësues të Akademisë Franceze (1, 1842) shkruhet se me emrin lat. *Ephyre* (Epir), Straboni kishte arritur të zbulonte nëntë qytete, dhe këtu nuk bëhet fjalë për emigrimet mesjetare të shqiptarëve, por për fiset autoktone të shqipfolësve të lashtë. Studiues arbëresh i shek.19, Stanislao Marchiano, shkruan se «duke shqyrtuar vendet, krahinat dhe zonat e konsideruara nga Homeri, Herodoti dhe Straboni si vendbanimet e të ashtuquajturve pellazgë, konstatova se të njejtat vende, krahina dhe zona kanë qenë dhe vijojnë të jenë të banuara edhe sot e kësaj dite nga albanët dhe ajo që vlen edhe më shumë për t'u përmendur është fakti se ato kanë emra albane». (21) Dukuri e përforcuar edhe nga gjuhëtari gjerman Hans Krahe (1898 – 1965), në të gjithë territorin e Greqisë gjenden të shpërndarë emërtime ilire, duke filluar nga veri-perëndimi në drejtim të jugut deri në Peloponez» (Krahe 1940, nr. 6, fq. 55-57).

Epir quhej në parahistori qyteti dhe krahina e Korinthit dhe banorët emërtoheshin Epirotë (Ephyreen). Pavarësisht kësaj dëshmie të Strabonit, në studimet historike, emigrantët apo luftëtarët epirotë të

ardhur nga Korinthe në Epidam (Durrës), apo qytetet e tjera me këtë emër, trajtohen si greke (lista më poshtë). Ky fakt dëshmohet edhe me emrin e lashtë Epidam të Durrësit dhe të qyteteve të tjera të Gadishullit: **Epidauros** (ne Dalmaci), e trajtuar si koloni greke në Adriatik–sot Cavtat, qytet port. **Epidauros** (Stobreč), gjithashtu «koloni greke» në lindje të Adriatikut-sot Stobreč, qytet bregdetar. **Epidauros** qytet grek në gjirin e Saronikës, qytet port. **Epidauros Limera**, një qytet i lashtë grek afër Monemvasia, në Laconi (Pelepenez), qytet bregdetar. **Epidauros Limira**, një provincë e Lakonisë.



1. **Dème d'Épidaure**, një komunë administrative në periferi të Peloponezitet, në Argolidë. Mban emrin e një qyteti të lashtë helen (qytetit Epidaur).

2. **Epidauros Limira** është një nga katër gadishujt të provincës së Lakonisë (Peloponez) që ka huazuar emrin e qyteti të lashtë **Épidaure Liméra**, në jug të gadishullit që kufizohet me Kepin **Malee**-s. (fjalë shqipe-kepi malor).

3. **Epir** (lat. Ephyre) siç u përmend më lart, emri i lashtë i qytetit të Korinthe. Në krahinën e Lokridës (Locris, afër Doris) në Helladë (shk. XII p.e.r.) banorët quheshin **Epicnemidiens** (Epiriote +), ndërsa në antikitet njiheshin si **Lejlekë**. Pjesa e dytë e emërtimit të dy qyteteve (Limera/ Limira) është fjalë po e gjuhës shqipe lime, e cila shpreh një hapësirë toke të kufizuar, në këtë rast nga deti, që sot e përdorim tek fjala «liman» dhe «limit». Pausania i përshkruan si qytete të ndodhura pranë detit. Në mesjetë banorët e Epidaur-it braktisën qytetin e lashtë, për të qenë më të sigurt dhe ndërtuan një të ri–Minoa (Monemvasia), i cili u bë qyteti më i rëndësishëm mesjetar në More, duke ruajtur gjatë shumë shekujve gjuhën dhe zakonet e tyre. (26) Emri «Epidam» i qyteteve, dëshmohet se ka qenë «shumë i lashtë» në kohën e Strabonit, që tregon edhe arsyen e mosnjohjes së kuptimit besimtar, gjuhësor dhe mitik të simbolit të shqiponjës.

Lidhja e emrit të Durrësit – Epidam me emrin biblik të Adamit?

Studiuesi i famshëm i besimeve Mircea Eliade, pohon se në shumë tradita besimtare të popujve, Krijuesi paraqitet në formën e një shpendi. Fatkeqësisht, as ai dhe as historianët e tjerë para tij, nuk arritën të përcaktojnë se cili shpend ka përfaqësuar Krijuesin, megjithëse mitet olimpike dhe objektet arkeologjike kanë dëshmuar se ishte Shqiponja. Për natyrën besimtare dhe mitike të shqiponjës në besimin e Atlantido-Pellazgëve i janë kushtuar shumë shkrime në dy librat Sellenizmi, besimi që sundon Botën» (F.Demi, 2016) dhe Mrekullia e mbijetesës (F.Demi, 2021) prandaj këtu, do të mjaftohem të përmend një dëshmi, që lidhet me zbulimin e origjinës fonetike të hieroglifëve egjiptiane. Siç u pa në fillim të shkrimit nga ana mitike, të dy emrat trajtohen si vepra (dam - ndarje) të kryera nga Zoti. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për ndërtimin gjuhësor të emrit të shqiponjës (Epi),

dhe gërmës zanafillore A, të emrit Adam. Për ta kuptuar barazimin Epi/shqiponjë=me gërmën A, na ndihmon perëndia hënore Thot, i njohur si shpikësi i alfabetit fonetik (hieroglifëve), i arteve dhe shkencës në Egjipt. Gjuhësia ka qenë shkencë e parë në Historinë e shekullit të 19-të, por edhe sot nuk ka mundur të zbulojë shkencërisht origjinën e disa gërmave që përfaqësojnë qysh nga Lashtësia, natyrën e tyre besimtare dhe mitike. Këtu bën pjesë, për nga rëndësia, veçanërisht gërma A e alfabetëve europiane. Studiuesi arbëresh Zef Katapano në librin e tij Thoti fliste shqip (Xhuzep Katapano, *Thot parlava albanese*), arriti në përfundimin se tingujt e hieroglifëve egjiptianë janë ndërtuar në gjuhën arbërore-shqipe, duke u bazuar tek gërma e parë e emrit të figurave (hieroglifëve). Ky studim nuk është pranuar për tu shqyrtuar nga studiuesit e huaj e ata shqipetarë, megjithëse është një nga zbulimet më madhore të shkencës së Egjiptologjisë, Historisë së Gjuhësive europiane dhe botërore dhe veçanërisht të Albanologjisë. Figura e shqiponjës lidhet me tingullin A me të cilin fillonte emri i saj në dialektin tosk të Epirit-*AIN* dhe sipas shkruësve të lashtë: rreth Dodonës banonin fiset ainiane apo iperiotë.

Ain dhe Ipe, në gjuhën arbërore emërtonin Shqiponjën. Studiuesja e filozofisë teosofiste (théosophie) H. Blavatsky, pohon se fjala ain do të thotë *ASGJË* dhe në gjuhën hebraike, *AIN* simbolizon atë që nuk ekziston. Në gjuhën hebraike, arabe, kaldaike dhe siriane, emri Ain tregon syrin. Syri në këto alfabete shpreh gërmën O, me kuptimin e hiçi-it. Studiuesi erudit Petro Zheji (*Shqipja dhe Sanskritishtja*) pohon se Simboli O është ai i qëndrës, i Frymës, i Zotit. Hiçit në hebraisht i thonë *AIN*, i cili shpreh ***Krijuesin që nuk mund të njihet.*** Krijuesi i alfabetit fonetik Thoti, vendosi në krye të hieroglifëve përfaqësuesin e Zotit, Shqiponjën të shprehur me simbolin A, për të deshmuar



se në kuptimin besimtar dhe gjuhësor, tingulli A → Shqiponja, siç është paraqitur edhe në papirus. Historia dhe Arkeologjia dëshmojnë se mbreti i parë i dinastive Atlantido-Pellazge në Kontinentin Afrikan, i hyjnizuar si perëndi hënore ishte Horosi, emri i të cilit në gjuhën kopte do të thotë «shqiponjë» dhe qyteti i tij emërtohej qytet i shqiponjave» (Nekhen Wikipedia). Për rrjedhje, gërma A tek emri Epidam, krahas kuptimeve të tjera në shqip (numërorit i pari, dhe foljes geg. asht/ është), në kuptimin e saj mitik përfaqëson edhe shqiponjën. Po kështu, tek pjesa e parë e emrit Ipedam (Epidam/ Durrësi) *IPE (EPI)*, sipas Xh. Katapanos gërma I, në doktrinën e Thotit përfaqëson Fuqinë Krijuese të Zotit. Ky shëmbull shpreh një dukuri edhe të disa gërmave të tjera (X, I, O, V, M) që tregon se si besimi parahistorik (*Hënoteizmi*) ka ndikuar në krijimin e gërmave të alfabetëve (që do trajtohet si studim më vete) dhe në rastin tonë, të barazimit: $A = AIN$ apo $EPI (IPE) = ZOTI$, nga rrjedh edhe barazimi gjuhësor e mitik i emrave Epidam (Ipedam)=Adam.

Dallimi i vetëm midis mitit të emrit ***Epidam*** dhe atij të ***Adam*** është ai kohor, dmth periudha shumë e lashtë e të parit, krahasuar me emrin e dytë—Adam, kur u krijua teologjia hebraike, e cila ja përshtati veprën e Zotit krijësës njerëzore. Ditën e gjashtë, Zoti krijoi kafshët e tjera dhe pastaj tha: të bëjmë njeriun me pamjen tonë dhe kështu e krijoi njeriun (*Genesi* 1-5). Në Enciklopedinë Treccani shkruhet se duke u bazuar tek tingujt, emri Adam do të thotë afërsisht: tokë, por është një përfundim jo i sigurtë. Nuk është tashmë një dukuri e rastit, kur kërkohet të shpjegohet kuptimi gjuhësor, që vetëm e folura e shqipëtarë-arbërve arrin t'i shpjegojë emrat e Lashtësisë.

PËRFUNDIME

1. Emri i qytetit-port të Durrësit, Epidam është një emër i stërlashtë (i periudhës faraonike të Thotit), sikurse i të gjitha qyteteve të tjera me të njejtin emër, që ishin në breg të ujrave detare, lumore apo liqeneve, të njohura si ngulimet më të herëshme të banorëve parahistorik. Ky emër ka si rrenjë emrin e shqiponjës Epi (Ipe) i bazuar tek gjuha dhe mitet e shqipfolësve pellazgo-arbër të Çamërisë (Epir).
2. Fjala Epidam shpreh filozofinë besimtare të qënies së *NJË ZOTI KRIJUES* të botës tokësore, nëpërmjet përfaqësuesit të tij-*SHQIPONJËS*. Miti i Adamit, është huazuar nga hartuesit e Biblës dhe të Kuranit prej mitologjisë atlantido-pellazge, fakt që e dëshmon edhe gjuha e shqipetaro-arbërve të sotëm.

MENDIME PËR TU MARRË PARASYSH

Forma e gabuar e emrit Epir dhe Shqipri në drejtshkrimin e sotëm është rrjedhojë e mosnjohjes nga ana e studiuesve të dialektit tosk dhe të origjinës së tyre mitike.

Filozofi Sami Frashëri duke folur për gjuhët e popujve në lashtësi pohon se: Përparimi i sajuar dhe letrar(i gjuhës–shën im)është çfaqur më vonë, kurse gjendja e natyrshme, është ajo bazë“(Sami Frashëri GJUHA, Stamboll 1886), Shkup 2002,f.79). Gjëndja natyrale e emrave dhe toponimeve është ajo që u trashëgua në mijra vjet në gojën e popullit.Një legjendë çame e Thesprotisë mbi Pirron e famshëm, Mbretin e Epirit: “Kur Pirro qe i vogël e çuan tek mbreti i Shkodrës: “O mbret i nderuar/ t’u rritet nami e rrofsh e klofsh sa malet/ Kaha *Iperoja* na të kemi ardhur/ të t’besojmë kët *zok* të *ipes*/ të na rritet ipje e vërtetë. (Dhimiter Pilika, *Pellazgët Origjina jonë e mohuar*, Botimet Enciklopedike,Tiranë,2005, f38) Drejtësinë e përdorimit të rrenjës Ipe në vend të asaj Epi, e dëshmon mitologjia. (Sellenizmi besimi që sundon botën,bot. Dudaj, Tirane, f101). Rekomandohet që të futet në drejtshkrim forma historike dhe mundësisht të zëvendësohet emri Durrës (siç kanë vepruar edhe shtetet e tjera), i vendosur nga romakët, me emrin e lashtë historik Ipedam, i cili harmonizohet edhe me emrin e vendit dhe të Kombit tone: Shqipëri-shqipëtar.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. **Adamo** (lat. *Adam* o *Adamus* o anche *Ada -ae*, gr. Ἀδάμ, ebr. *Ādām*, di origine incerta – Nome, secondo il racconto biblico del *Genesi*, del primo uomo creato da Dio e progenitore del genere umano) (Adamo, Vocabolario on line.). <https://www.treccani.it/vocabolario/adamo/>
2. The famous *The Creation of Adam* on the Sistine Chapel ceiling, by Michelangelo c. 1512 Adam is iconic of humanity, being a reminder that Man is created in the Image and Likeness of God (Gen 1:26). <https://en.wikipedia.org/wiki/God> ; <https://it.depositphotos.com/10955286/stock-photo-genesis-frescoes.html>
3. Hebrew Bible, also called Hebrew Scriptures, Old Testament, or Tanakh, collection of writings that was first compiled and preserved as the sacred books of the Jewish people. It also constitutes a large portion of the Christian Bible. <https://www.britannica.com/topic/Hebrew-Bible>
4. Petro Zhei “Shqipja dhe Sanskritishtja” (pjesa e dytë), Tiranë, Tertiumdatur, 2006, f.151
5. Nikoll Ketta , *Tesoro di Notizie, su de Macedoni* (Dunque nissun altra nazione del mondo ha tanti, e si antichi monumenti , come la nostra, intorno ai suoi nomi, che dalla greca , o dalla macedonica lingua poi i romani a tempo di suo impero mutandoli in latino, li resero Albania ,Albanum, Albanus e simili , come in fatti già prima i romani mutarono il greco ... in Alba Longa.), Helix media Editore, Contessa Entellina, 2002, f.173
6. Dhimitër Pilika , *Pellazget origjina e jonë e mohuar*, Botimet Enciklopedike, Tiranë, 2005, f.170
7. Dopo la vittoria ad Eraclea, Pirro coniò alcune monete celebrative della battaglia. Lo stile di queste emissioni è talmente differente dalla precedente produzione di Eraclea che si pensa vi abbia collaborato mano d'opera greca al seguito del Re epirota. (Aquila su fulmine / Tripode delfico; SNG ANS 409) <http://www.roth37.it/COINS/Pirro/monetazione.html>
8. Dr.Mojkom Zeqo: *Dy emrat e një qyteti të lashtë*, Tiranë, 1 Gusht 2019 <http://www.pashtriku.org/?kat=45&shkrimi=9036>
9. Dr.Mojkom Zeqo, po aty
10. Hava – Sali Hidri, *Historia e Durrësit*, f. 13,14, 22, 31,32.
11. (Plin. Nat. 3.23; Pomp. Mela, 2.3.12.) (Some have affirmed that the Romans, considering the word Epidamnus to be of ill omen, called it Dyrrhachium from the ruggedness of its situation. (Plin. Nat. 3.23; Pomp. Mela, 2.3.12.) (DYRRHA'CHIUM) <http://www.perseus.tufts.edu/hopper/text?doc=Perseus:text:1999.04.0064:id=dyrrhachium-geo>
12. Xhuzepe Katapano, *THOT-i FLISTE SHQIP* ose “Thot-i boreal, Iliro-Shqiptar, i dha Botës Kumtin e parë të Lirisë dhe të Dritës” botim në Itali nga Bardi Editore, Roma,1984) në shqip, Botimet enciklopedike , 2007 , f12, 39
13. INFINITO(Fil.) - Ciò che non ha limite, misura o conclusione. Gli Epicurei, richiamandosi anche a Democrito, sono i soli ad avere un'idea positiva dell'infinito, poiché lo identificano con il vuoto, condizione originaria dell'universo e del suo divenire. I Neoplatonici ammettono

finito ed infinito nell'Uno divino (...) Cusano unifica il concetto astratto dell'infinito matematico con l'infinità reale di Dio. Bruno vede nell'infinito il fondamento stesso dell'universo, essendo il mondo penetrato in ogni punto dall'attività creatrice di Dio.) <https://www.teosofica.org/it/materiale-di-studio/glossario/glossario/,32?alfa=I&start=160>

14. (L'ápeiron (dal greco antico ἄπειρον, ápeiron, composto da ἄ-, a-, «non», e πείραρ, peirar, «limite» o «fine»^[1], forma ionica di πέρας, peras^[1]), il cui significato letterale è «illimitato», «infinito» o «indefinito»,^[1] rappresenta, secondo la filosofia di Anassimandro, l'archè (ἀρχή), cioè l'origine e il principio costituente dell'universo. Esso è una realtà infinita, indeterminata, eterna, indistruttibile e in continuo movimento). <https://it.wikipedia.org/wiki/%C3%81peiron>
15. (C. M. Bowra (1957) *The Greek experience*. World Publishing Co. Cleveland and New York. pp. 168–169) <https://en.wikipedia.org/wiki/Apeiron>
16. Leucade était anciennement une presqu'île de l'Acarnanie, car Homère l'appelle *Aktên Epeiroio*, et, comme le mot *Epeiroio* s'appliquait dans sa pensée à la côte de terre-ferme qui fait face à Ithaque et à Céphallénie ; Ceux qui habitent l'EPIROS et toute la côte en face des îles», l'EPIROS, OU TERRE-FERME, à cette époque, n'ayant pas encore reçu le nom d'Acarnanie,) Strabo X, 2 - Acharnanie, Etolie et îles adjacentes. <https://mediterranees.net/geographie/strabon/X-2.html>
17. https://fr.wikipedia.org/wiki/Acarnanie#/media/Fichier:Aetolia_map.jpg
18. Dr.Mojkom Zeqo, *Dy emrat e një qyteti të lashtë*, po aty
19. Carlo Rovelli, *Anaximandre de Milet, ou la Naissance de la pensée scientifique*, Paris: Dunod, 2009. (2011). *The First Scientist, Anaximander and his Legacy*. Yardley: Westholme. *Histoire de la botanique*, Delachaux et Niestlé, 2004, édition augmentée 2009, 3e édition 2015) <https://learngraspshow.eu/fr/2018/02/07/une-etincelle-de-genie-anaximandre-de-milet-610-545/>
20. [Palladio \(mitologia\) - Wikipedia ; it.wikipedia.org/wiki/Palladio \(mitologia\)](https://it.wikipedia.org/wiki/Palladio_(mitologia))
21. Stanislao Marchiano *Studime Filologjike , zhvilluar me gjuhen Pellazgo Albane .* Napoli 1882, Gent Grafik ,2019 f.5
22. Shpresa Musaj *Gjuha –Deshmi e lashtësisë sonë mijëravjeçare*, shtëpia botuese “Ymeraj”, Fier 2012 f.128
23. EPHYRE- Fille de l’Ocean ,qui établit sur territoire de Corinthe. ; Ephyre (geogr.ant.) - nome done primitivement a Corinth; Ephyre était aussi le nom de plusieurs autres villes, Strabon en comple jusju’a neuf. EPHYREEN-abitant de Corinthe. Complément du dictionnaire de l'Académie Française, 1 , 1842, f.423) https://books.google.al/books?id=AlRpDBtmjIsC&pg=PA423&lpg=PA423&dq=%C3%A9picn%C3%A9midien&source=bl&ots=lkncr2NiPL&sig=ACfU3U1KPr5wMEfe4YRvGPWO16nNHqQ_w&hl=fr&sa=X&ved=2ahUKEwi-ofXn_unyAhUNwKQKHcVJDvkQ6AF6BAghEAM#v=onepage&q=%C3%A9picn%C3%A9midien&f=false ; <http://www.perseus.tufts.edu/hopper/text?doc=Perseus%3Atext%3A1999.04.0064%3Aentry%3DEphyra-geo02>
24. [https://en.wikipedia.org/wiki/Epidaurus \(disambiguation\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Epidaurus_(disambiguation))

25. https://en.wikipedia.org/wiki/Epidaurus_Limera ; Epicnemidien – (antic) Locrians de epicnemidiens. Strabo *Géographie*, IX, 4, 1.) <https://www.mediterranees.net/geographie/strabon/IX-4.html>
26. Épidaure Limira. https://en.wikipedia.org/wiki/Epidauros_Limira); ^ Pausanias, *Description of Greece*, 2. 26. 2; respecting the Argive version, he cites Hesiod's *Megalai Ehoiai*) [https://en.wikipedia.org/wiki/Epidauros_\(mythology\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Epidauros_(mythology))
27. Mircea Eliade ...(In molte tradizioni il Creatore è immaginato in forma di uccello. Si tratta di una “concretizzazione” del simbolo originario: lo Spirito divino trascende la massa acquatica ,è libero di muoversi, e di conseguenza “vola” come un ucelo. Ricordiamo che « l’uccello » è una delle immagini archetipe dello spirito (vol.1, f182)
28. (Thot régnait sur tout ce qui comporte une opération intellectuelle : identifié à la Lune, il est le dieu qui mesure et calcule le temps ; secrétaire d'Osiris et greffier dans la psychostasie, il est l'inventeur de l'écriture et, par suite, des sciences et des arts.) <https://www.universalis.fr/encyclopedie/hermetisme/1-de-thot-a-hermes-trismegiste/>
29. Helena P. Blavatsky, (Dice Filone in Quaestiones et Solutiones in Genesis “Il Secondo Dio è la sua Sagghezza (quella di Ain Soph)”. La Divinità è *NESSUNA COSA* (No-thing); essa è senza nome perciò è chiamata Ain Soph, dato che la parola Ain significa *NULLA AIN* (Ebr.) - Il non esistente; la divinità in riposo ed assolutamente passiva (w.w.w.) (Glosario teosofico H.Balvatsky germa A)
30. Gastone Ventura , *Appunti sui primi elementi di lingua ebraica*. (La cabala operativa di R. Ambelain Redazione di "Kether"Rassegna siciliana di studi Martinisti dell'OMAT – 1997) http://www.iltibetano.com/testi/martinismo_lingua%20ebraica.htm
31. Petro Zheji, *Shqipja dhe Sanskritishtja* (pjesa e dytë),Tiranë, Tertiumdatur, 2006 f 77,413)
32. <https://www.ancient-egypt-online.com/hieroglyphics-alphabet.html> .
33. Xhuzepe Katapano, po aty, f81
34. (Sesto Giorno-Dio creò gli altri animali poi disse: "facciamo l'uomo alla nostra immagine". Adunque creò l'uomo.) <https://www.docsity.com/it/la-creazione-del-mondo/7286056/> (*Genesi* 1-5) <https://www.treccani.it/enciclopedia/adamo/>
35. La derivazione del vocabolo non è sicura. Nel racconto biblico esso è evidentemente messo in relazione col vocabolo 'adhāmāh "suolo" (*Genesi*, II, 5-7; III, 19-23), [https://www.treccani.it/enciclopedia/adamo_%28Enciclopedia-Italiana%29/#:~:text=Il%20nome%20di%20Adamo%20\(dall,biblica%20di%20non%20trascurabile%20](https://www.treccani.it/enciclopedia/adamo_%28Enciclopedia-Italiana%29/#:~:text=Il%20nome%20di%20Adamo%20(dall,biblica%20di%20non%20trascurabile%20)